



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 gusht 2020
Nr. ref.: RK 1600/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI79/19

Parashtrues

N.T.P. Arta-Impex

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, E. Rev. nr. 7/2019, i 2 prillit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania N.T.P. Arta-Impex me pronar Besim Çallaku nga Kaçaniku (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), përfaqësuar nga Valon Hasani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjyimit të Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 7/2009] të 2 prillit 2019 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ac. Nr. 222/2018] të 4 dhjetorit 2018, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike [I.EK.nr.434/2016] të 4 qershorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113 (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe 21 (4) [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 maj 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 23 maj 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 2 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 1 korrik 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Bazuar në dokumentet e dorëzuara rezulton se më 18 mars 1998, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë me fabrikën e çimentos “NSH Sharr Çimentorja” nga Hani i Elezit për furnizim me lëndë të parë dhe repromaterial. Kontrata në fjalë parashikonte që parashtruesi i kërkesës do ta furnizonte fabrikën “NSH Sharr Çimentorja” me një sasi materiali të njohur si “Opalit/Tuf” dhe në këmbim

do të pranonte një vlerë ekuivalente të çimentos nga fabrika "NSH Sharr Çimentorja".

10. Më 13 qershor 2000, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejshëm, AKM) si administratore ligjore e fabrikës së çimentos "NSH Sharr Çimentorja" kishte lidhur marrëveshje me një kompani tjetër të quajtur "Sharr Beteiligungs" për qiranë, menaxhimin dhe operimin e fabrikës së çimentos "NSH Sharr Çimentorja" me ç 'rast AKM-ja ishte qiradhënës kurse "Sharr Beteiligungs" ishte qiramarrës. Në marrëveshje për qiranë, menaxhimin dhe operimin e fabrikës së çimentos "NSH Sharr Çimentorja", mes tjerash, ishte theksuar se qiramarrësi ("Sharr Beteiligungs") nuk do të ketë asnjë obligim ndaj kërkesave kreditore dhe në rast se i drejtohet ndonjë kreditor e vetmja gjë që do ta bëj ai është që kreditorin ta drejtoj tek qiradhënësi (AKM).
11. Më 29 nëntor 2005, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm, DHPGJS) kundër të paditurve AKM, fabrikës së çimentos "NSH Sharr Çimentorja" nga Hani i Elezit dhe "Sharr Beteiligungs" nga Hani i Elezit duke kërkuar pagesën për borxhin kryesor në vlerë prej 711.000.00 euro; shumen prej 106.650.00 euro në emër të kamatës ligjore prej 3 % shumën prej 497.700.00 euro për kamatë ndëshkuese prej 14 % dhe shumen prej 593.394.40 euro në emër të fitimit të humbur.
12. Më 20 janar 2006, pas shqyrtimit të padisë së parashtruesit të kërkesës, DHPGJS-ja me Aktvendim [SCC-05-0532] e hodhi poshtë të papranueshme padinë e paraqitur kundër AKM-së kurse padinë kundër dy të paditurve tjerë ("NSH Sharr Çimentorja" nga Hani i Elezit dhe "Sharr Beteiligungs" nga Hani i Elezit) e përcolli tek Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë. DHPGJS-ja arsyetoi se në bazë të nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, AKM-ja nuk mund të jep përgjigje për borxhet e ndonjë ndërmarrjeje dhe se padia kundër saj hedhet poshtë e papranueshme. Sa i përket padive kundër "NSH Sharr Çimentorja" nga Hani i Elezit dhe "Sharr Beteiligungs" nga Hani i Elezit, DHPGJS-ja konstatoi se në bazë të nenit 17 (b) të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2003/13, DHPGJS-ja me vetë iniciativë mund ta përcjellë lëndën tek gjykata kompetente.
13. Më 2 qershor 2006, AKM-ja kishte dorëzuar përgjigje në padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me ç 'rast njoftoi se bazuar në nenin 29.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 dhe në mbrojtje të të drejtave të paditurit "NSH Sharr Çimentorja" pajtohet që ta pranon kërkesën për borxhin kryesor në vlerë prej 711.000.00 euro, por jo edhe kërkesat për kamatë ligjore, kamatë ndëshkuese dhe fitimin e humbur.
14. Më 16 qershor 2006, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë duke vepruar sipas Aktvendimit të DHPGJS me Aktgjykim të pjesshëm II. C. nr. 51/006 obligoi të paditurin fabrika e çimentos "NSH Sharr Çimentorja" nga Hani i Elezit që parashtruesit t'ia paguaj shumën e borxhit kryesor në lartësi prej 710.730.10 euro në afat prej tetë (8) ditësh, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Kurse për çështje të kamatës së rregullt, kamatës ndëshkuese dhe kompensimin e dëmit nga baza e fitimit të humbur, Gjykata Ekonomike e Qarkut e pranoi tërheqjen e padisë nga ana e paditësit ndaj të paditurit të parë "NSH Sharr Çimentorja" nga Hani i Elezit, ashtu që, për atë çështje gjykata do të vendos me

aktgjykim të mëvonshëm në mes parashtruesit të kërkesës dhe të paditurit të dytë “Sharr Beteilinginungs” nga Hani i Elezit.

15. Më 29 shkurt 2008, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë kundër të paditurit “Sharr Beteilinginungs” nga Hani i Elezit në emër të kamatës së rregullt, kamatës ndëshkuese dhe fitimit të humbur.
16. Më 27 qershor 2008, Gjykata Ekonomike e Qarkut përmes Aktgjykimit [II. C. nr. 51/2006] : (i) aprovoi pjesshëm kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe obligoi të paditurin “Sharr Beteilinginungs” nga Hani i Elezit që parashtruesit të kërkesës t’ia paguaj në emër të kamatës së rregullt prej 5 % shumën prej 76.500.00 euro, në afat prej tetë (8) ditësh nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm; (ii) refuzoi të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës që të obligohet i padituri Sharr Beteilinginungs” nga Hani i Elezit që në emër të kamatës ndëshkuese ta paguaj shumën prej 150.00.00 euro; dhe, (iii) refuzoi të pabazuar pjesën e kërkesëpadi së për pagimin e shumës prej 214.00.00 euro në emër të fitimit të humbur. Gjykata Ekonomike e Qarkut po ashtu kishte përcaktuar se kundër aktgjykimit të saj në afat prej 60 ditësh është e lejuar ankesa në DHPGJS.
17. Më 20 nëntor 2011, pala e paditur “Sharr Beteilinginungs” nga Hani i Elezit paraqiti ankesë në DHPGJS kundër aktgjykimit të lartpërmendur duke pretenduar shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
18. Më 5 shtator 2014, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së (Aktvendim AC-II-12-0180) e shpalli vetveten jo-kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e “Sharr Beteilinginungs” nga Hani i Elezit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut [II. C. nr. 51/2006] të 27 qershorit 2008. Kolegji i Ankesave të DHPGJS-së konstatoi se objekti i padisë bazuar në ligjin për gjykatat bie nën juridiksionin e gjykatave të rregullta përkatësisht kjo padi duhet të shqyrtohet nga Gjykata e Apelit të Kosovës.
19. Në një datë të paspecifikuar, pala e paditur “Sharr Beteilinginungs” nga Hani i Elezit por edhe parashtruesi i kërkesës paraqitën ankesat e tyre në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut [II. C. nr. 51/2006] të 27 qershorit 2008, duke pretenduar shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 5 shtator 2016, Gjykata e Apelit me Aktvendim [Ac. nr. 151/2014], e prishi Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut [II. C. nr. 51/2006] të 27 qershorit 2008 dhe çështjen e ktheu në rigjykim dhe rivendosje. Gjykata e Apelit kishte konstatuar: (i) se aktgjykimi i goditur është karakterizuar me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 (1) dhe 182 (2) n); (ii) aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet; (iii) aktgjykimi është i pakuptueshëm dhe kontradiktor; dhe se, (iv) nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta.

21. Bazuar në materialin në dispozicion, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në rigjykim të çështjes në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kishte paraqitur padi kundër të paditurës “Sharr Beteiligungs GMBH”, për kompensimin e shumës prej 711.000.00 euro, në emër të borxhit kryesor dhe shumës prej 593,994.40 euro në emër të fitimit të humbur. Gjithashtu, Parashtruesi i kërkesës në rigjykim kishte propozuar nxjerrjen e provës së ekspertizës gjyqësore financiare.
22. Më 4 qershor 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike me Aktgjykim [I. EK. Nr. 434/2016] e refuzoi të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për të obliguar të paditurën “Sharr Beteiligungs” nga Hani i Elezit për kompensimin e shumës prej 711,000.00 euro, në emër të borxhit bazë dhe të shumës prej 593,994.40 euro, në emër të fitimit të humbur. Pas vlerësimit të provave, Gjykata Themelore, mes tjerash, konstatoi: (i) se nuk ishte kontestues fakti që parashtruesi i kërkesës dhe fabrika e çimentos NSH “Sharr Çimentorja” nga Kaçaniku në vitet 1998-99 kanë qenë në raport kontraktues me ç ‘rast parashtruesi i kërkesës e furnizonte fabrikën e çimentos “Sharr” me lëndë të parë për prodhimin e çimentos të ashtuquajtur “Tuf” ndërsa kjo e fundit kishte marrë detyrime që parashtruesin ta kompensoj me çimento; (ii) se më 13 qershor 2000, AKM-ja si administratore ligjore e fabrikës së çimentos NSH “Sharr Çimentorja” kishte lidhur marrëveshje me “Sharr Beteiligungs” për qiranë, menaxhimin dhe operimin e fabrikës së çimentos “NSH Sharr Çimentorja” , me ç ‘rast AKM ishte qiradhënës kurse “Sharr Beteiligungs” ishte qiramarrës; (iii) se me marrëveshje për qiranë, menaxhimin dhe operimin e fabrikës së çimentos “NSH Sharr Çimentorja” , “Sharr Beteiligungs” nuk kishte marrë detyrimet për pagesat e borxheve të mëparshme. Lidhur me borxhet e mëparshme, Gjykata e Apelit kishte shtuar se në kapitullin katër pika 4.2 të marrëveshjes për qiranë, menaxhimin dhe operimin e fabrikës së çimentos “NSH Sharr Çimentorja” ishte theksuar se UNMIK-u do të përpiqet arsyeshëm që të mbrojë punën e fabrikës nga kërkesat e çfarëdo kreditori, të cilat i përkasin periudhës para hyrjes në fuqi të marrëveshjes për qiranë. Po ashtu ishte theksuar se qiramarrësi (“Sharr Beteiligungs”) nuk do të ketë asnjë obligim ndaj kërkesave kreditore dhe në rast se i drejtohet ndonjë kreditor e vetmja gjë që do ta bëj ai është që kreditorin ta drejtoj tek qiradhënësi (AKM). Gjykata Themelore konstatoi se pales se paditur “Sharr Beteiligungs” i mungon legjitimiteti pasiv përkatësisht i mungon përgjegjësia për kthimin e borxheve eventuale apo detyrimet për kamatëvonesat apo fitimin e humbur. Gjykata Themelore-konstatoi se në kapitullin 4 të marrëveshjes për qiranë, pika 4.2 është përcaktuar qartazi se “Sharr Beteiligungs”, si qiramarrëse, nuk ka asnjë detyrim lidhur me borxhet paraprake të fabrikës së çimentos “NSH Sharr Çimentorja”.
23. Lidhur me ekspertizën e ekspertëve, Gjykata Themelore kishte shtuar: “[...] është miratuar propozimi i paditësit dhe është vendosur nxjerrja e provës së ekspertizës gjyqësore financiare. Eksperti gjyqësor i caktuar V.I., e ka punuar raportin e ekspertizës, mbi të cilin pala e paditur ka parashtruar vërejtje dhe njëkohësisht ka paraqitur propozim për ekspertizë të re financiare. Propozimi i të paditurit është miratuar nga gjykata dhe për ekspert gjyqësor financiar është caktuar R.B., i cili po ashtu ka punuar raportin e ekspertizës dhe ja ka dorëzuar gjykatës [...] pastaj procedura ka vazhduar me leximin administrimin e provave [...] ekspertiza nga eksperti financiar V.I., [...] ekspertiza financiare nga eksperti R.B., të dhënat e biznesit NTP Arta Impex”.

24. Më 4 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës ishte që të obligohet “Sharr Beteiligungs” *“që ta paguaj dëmin në tërësi në vlerë prej 1,141,550,02 Euro në bazë të dy ekspertizave të nxjerra nga Gjykata”*.

25. Më 4 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit me Aktgjykim [Ae. Nr. 222/2018] e refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [I. EK. Nr. 434/2016], të Gjykatës Themelore të 4 qershorit 2018. Gjykata e Apelit vlerësoi se aktgjykimi i goditur është i drejtë juridikisht dhe se nuk është karakterizuar me shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Lidhur me pretendimin për pagesat e borxheve eventuale, detyrimeve mbi kamatëvonesën, dhe fitimin e humbur, Gjykata e Apelit e miratoi qëndrimin e gjykatës themelore se palës së paditur “Sharr Beteiligungs” i mungon legjitimiteti pasiv përkatësisht i mungon përgjegjësia për kthimin e borxheve eventuale apo detyrimet për kamatëvonesat apo fitimin e humbur. Gjykata e Apelit-sikurse gjykata themelore-konstatoi se në kapitullin 4 të marrëveshjes për qiranë, pika 4.2 është përcaktuar qartazi se “Sharr Beteiligungs”, si qiramarrëse, nuk ka asnjë detyrim lidhur me borxhet paraprake të fabrikës së çimentos “NSH Sharr Çimentorja”.

26. Më 8 janar 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe shkelje esenciale të dispozitave procedurale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen, ashtu që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia në shumën e përcaktuar nga eksperti RB, në emër të fitimit të humbur dhe t’i kompensohen shpenzimet e procedurës kontestimore. Parashtruesi i kërkesës kishte propozuar si alternativë që revizioni të aprovohet i bazuar dhe të anulohen aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës se Apelit dhe që çështja të kthehet në rigjykim tek gjykata e shkallës së parë.

27. Më 15 janar 2019, parashtruesi i kërkesës plotësoi revizionin e tij në lidhje me pretendimet për fitimin e humbur, lartësinë e dëmit të pësuar, shkelje të nenit 8 të LPK-së, administrimin e provës (email i datës 31.05.2016) për çka Gjykata e Apelit nuk ishte shprehur nëse i ka falur besimin ose jo dhe mos marrjen për bazë të ekspertizave të ekspertëve V.I., dhe R.B.

28. Më 24 janar 2019, Pala e paditur “Sharr Beteiligungs” kishte paraqitur përgjigje ndaj revizionit të parashtruesit të kërkesës me propozim që revizioni të hedhet i palejuar pasi që ka të bëjë ekskluzivisht me pretendimet në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe që aktgjykimi i kundërshtuar të vërtetohet.

29. Më 29 janar 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së palës së paditur, duke pretenduar se gjykatat e instancës së ulët kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale sepse, mes tjerash, nuk kanë shpjeguar: (i) nëse pala e paditur “Sharr Beteiligungs” kishte fituar të drejtën e pronësisë ndaj lëndës së parë që gjendej në stoqet e fabrikës të furnizuar nga

parashtruesi i kërkesës me rastin e lidhjes së kontratës për komercializim; (ii) në bazë të dispozitave të kontratës për komercializim, a e ka blerë “Sharr Beteilinginungs”, lëndën e parë që gjendej në stoqe nga UNMIK-u; dhe, (iii) a ka pasur detyrim “Sharr Beteilinginungs” që lëndën e parë që kishte qenë në pronësi të parashtruesit të kërkesës, që të njëjtën t’ia kthente ose paguante parashtruesit të kërkesës; (iv) meqenëse pala e paditur as nuk e ka kthyer e as nuk e ka paguar lenden e parë, a i ka shkaktuar dëm paditësit në formën e fitimit të humbur?; dhe (v) kur ishte ndërmarrë veprimi dëmtues i Sharr Beteilinginungs karshi Arta Impex?.

30. Më 2 prill 2019, Gjykata Supreme me Aktgjykim [E. Rev. nr. 7/2019] e refuzoi të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit [Ae. nr. 222/2018] të Gjykatës së Apelit, të 4 dhjetorit 2018. Gjykata Supreme vlerësoi se aktgjykimet e goditura të gjykatave të instancës më të ulët kanë vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, kanë zbatuar drejtë të drejtën materiale dhe se përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështje juridike. Lidhur me pretendimin për borxhin kryesor, kamatëvonesën, fitimin e humbur, Gjykata Supreme miratoi qëndrimin e gjykatave të instancës më të ulët se palës së paditur “Sharr Beteilinginungs” i mungon legjitimiteti pasiv përkatësisht i mungon përgjegjësia për kthimin e borxheve eventuale apo detyrimet për kamatëvonesat apo fitimin e humbur. Gjykata Supreme-sikurse gjykatat e instancës më të ulët-konstatoi se në kapitullin 4 të marrëveshjes për qiranë, pika 4.2 është përcaktuar qartazi se “Sharr Beteilinginungs”, si qiramarrëse, nuk ka asnjë detyrim lidhur me borxhet paraprake të fabrikës së çimentos “NSH Sharr Çimentorja”.
31. Lidhur me plotësimin e revizionit të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata Supreme kishte shtuar se administrimi i provës “email i 31 majit 2016”, pasqyra e kostos ditore të makinerisë, formulari i ATK-së janë pretendime që kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, për të cilat në bazë të nenit 214 të LPK-së revizioni nuk mund të paraqitet.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.
33. Parashtruesi i kërkesës fillimisht duke cituar neni 154 dhe 155 të ligjit të vjetër për marrëdhëniet e detyrimeve të publikuar në gazetën zyrtare të RSFJ-së(1978), i cili ka qene ne fuqi ne kohen kur është krijuar marrëdhënia detyrimore kontestuese ne mes te palëve e qe sipas parashtruesit “bën pjese tek Kaptina 2 e Kreut II te Ligjit të ri për marrëdhëniet e detyrimeve (Ligji Nr. 04/L-077) pretendon se *“mund te arrihet përfundimi se detyrimi mund te linde nga nje raport kontraktual mes paleve (Kontrata), por edhe mund te lind nga nje raport jo-kontraktual ne mes paleve (Demi, Fitimi pa baze, Gjerimi i punëve te huaja pa porosi dhe shprehja e njëanshme e vullnetit)”*.
34. Parashtruesi specifikisht thekson: *“Ne tere procedurën kontestimore te zhvilluar para tri instancave gjyqësore (Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme) pala paditëse vazhdimisht ka kërkuar qe te aprovohet*

kërkesëpadia e tij për kompensim demi, ne formën e fitimit të humbur, e qe është burim jo-kontraktual i detyrimit, dhe atë për periudhën pas nënshkrimit të Kontratës se Komercializimit, ndërsa gjykatat e rregullta ne te tri instancat kane vendosur qe ta refuzojnë kërkesën e paditësit me arsyetimin se nuk kishte ndonjë raport kontraktual ne mes te ndërmarrjes shoqërore dhe palës se paditur për te marre përsipër borxhet para nënshkrimit të Kontratës se Komercializimit”.

35. *Parashtruesi tutje thekson se përderisa “kompensimin për detyrimin kontraktual (kompensimin e borxhit) e ka vendosur Gjykata Ekonomike e Qarkut ne Prishtine me Aktgjykimin e pjesshëm II.C.n3.51/2006 duke detyruar kështu NSH Sharr, qe te paguaj shumen prej 710,320.72 Euro,” procedurat për kompenzimin e demit jo kontraktual i ka vazhduar “ndaj Sharr Beteiligungs GMBH por se janë refuzuar nga Gjykata Ekonomike e Qarkut ne Prishtine (me Aktgjykim II.C.nr 51/2006) pa dhënë asnjë arsyetim për këtë refuzim”.*
36. *Sipas parashtruesit “edhe ne procedure te rigjykitimit pranë Gjykatës Themelore ne Prishtine-Departamenti për Çështje Ekonomike (Aktgjykimi I.EK.nr.434/2016, i datës 04.06.2018) “ e “ edhe Gjykata e Apelit e japin te njëjtin arsyetim se nuk ka asnjë raport kontraktual me te cilin barten detyrimet nga ana e NSH Sharr tek Sharr Beteiligungs GMBH, duke e deformuar ne tërësi kërkesëpadinë e palës paditëse”.*
37. *Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme me Aktgjykimin [E. Rev. nr. 7/2009] ka kryer të njëjtat shkelje sikurse gjykata e instancës më të ulët sepse vetëm ka përsëritur arsyetimin e tyre. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Gjykata Supreme vetëm shkarazi ka trajtuar argumentet e paraqitura në revizion sepse dispozitat e ligjore të përmendura nga parashtruesi i kërkesës janë mbështetur në ligjin e vjetër për marrëdhëniet e detyrimeve të publikuar në gazetën zyrtare të RSFJ-së, kurse Gjykata Supreme ka interpretuar e zbatuar dispozitat e ligjit të ri për marrëdhëniet e detyrimeve (Ligji Nr. 04/L-077).*
38. *Në lidhje me këtë parashtruesi thekson “ne revizion Arta Impex as nuk ka pretenduar se kemi te bëjmë me Nenin 17 te LMD-se se ri, apo lidhjes se detyrueshëm te kontratës, por kemi te bëjmë me Nenin 16 te LMD-se se vjeter) per shkak te gabimit teknik është përmendur Neni 17, por qe nga konteksti shihet qe kemi te bëjmë me Nenin 16 te Ligjit te Vjetër Për Marrëdhëniet e Detyrimeve). Pra Gjykata Supreme e Kosovës refuzon nje argument te paqene te Arta Impex.” Parashtruesi gjithashtu thekson se “Gjykata Supreme ka refuzuar edhe nje argument tjetër te Arta Impex duke ju referuar nenit 154 te Ligjit te Ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve, mirëpo Arta Impex ne revizion i referohej Nenit 154 te Ligjit te vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve”.*
39. *Parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij Gjykata Supreme ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 (1) të KEDNJ-së dhe 31 të Kushtetutës. Sipas parashtruesit të kërkesës “nacioni i gjykitimit të drejtë kërkon që një gjykatë ankimore që ka dhënë arsyetim të pakët për vendimin e saj, qoftë duke inkorporuar arsyetimet e gjykatave më të ulëta, duhet që të paktën adresojë çështjet esenciale që janë paraqitur për vendimmarrje te kjo gjykatë dhe jo vetëm të përkrahë gjetjet e mëparshme pa asnjë konsideratë [...] Gjykata Supreme e Kosovës nuk u përgjigjet çështjeve esenciale dhe thelbësore të*

ngritura nga ana e paditësit (se bëhej fjalë për kërkesën për kompensim dëmi të shkaktuar nga Sharr Beteiligungs, pas nënshkrimit të Kontratës së Komercializimit), dhe përveç kësaj edhe i refuzon disa “argumente” të cilat nuk i përkasin paditësit”.

40. Për të mbështetur pretendimet e tij për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të GJEDNJ-së Helle kundër Finlandës dhe Aktgjykimit të Gjykatës në rastin nr. KI72/12.
41. Parashtruesi i kërkesës thekson se “*Të tri instancat gjyqësore e ne veçanti vendimi i Gjykatës Supreme lidhur me revizionin nuk kane respektuar standardin e arsytimit të vendimeve gjyqësore, dhe si të tilla bien ndesh me garancitë e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*” Gjithashtu parashtruesi shton se “*është i vetëdijshëm se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me interpretimin e dispozitave ligjore pasi që kjo është detyrë primare e gjykatave të rregullta (Brualla Gomez de la Torre kundër Spanjes, Aktgjykimi i datës 19 dhjetor 1997, paragrafi 31). Mirëpo kjo nuk zbatohet edhe në rastet kur kemi raste të një arbitrariteti të dukshëm*”. Në lidhje me këtë parashtruesi thirret në rastet e GJEDNJ-së “*Farbers dhe Harlanova kundër Letonisë nr 57313/00, Aktgjykimi i 6 Shtatore 2001 dhe Beyler kundër Italisë (GC) nr.33202/96, paragrafi 108, në kontekst të Nenit 1 të Protokollit 1*”.
42. Parashtruesi i kërkesës shton se “*për me tepër, të tri instancat gjyqësore vendosin për një çështje që ishte vendosur kundër NSH Sharr me aktgjykim të formës së prere (borxhi), në vend se të vendosnin për kërkesë padinë e pavendosur, e që ishte kërkesa për kompensimin e dëmit në formën e fitimit të humbur. Përveç arbitrariteti të treguar në shqyrtimin e kërkesëpadisë së paraqitësit të kërkesës kemi vendimmarrje edhe në kundërshtim me një vendim res judicata*”.
43. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se rasti i tij nuk është zgjidhur brenda një afati të arsyeshëm siç përcaktohet me standardet e GJEDNJ-së: “[...] e gjitha kjo procedurë gjyqësore që është filluar nga viti 2005 e ka vazhduar deri në vitin 2019 nuk i përmbush standardet për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme [...] është dashur që të kalojnë 14 vite nga fillimi i procedurës kontestimore e deri në zgjidhjen përfundimtare nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës”.
44. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata : “(i) Të shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) Të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lexuar së bashku me nenin 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin Rev.nr.7/2009, të datës 02.04.2019, nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës me Aktgjykimin Ae.nr.222/2018, të datës 04.12.2018 si dhe nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin I.Ek.nr.434/2016, të datës 04.06.2018 si dhe gjithë procedurës së zhvilluar para gjykatave të rregullta; (iii) Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.7/2019, të datës 02.04.2019, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.222/2018, të datës 04.12.2018 si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë I.Ek.nr.434/2016, të datës 04.06.2018”.

Pranueshmëria e kërkesës

45. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

46. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

47. Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

48. Gjykata po ashtu u referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

49. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë. (Shih, rastin e Gjykatës nr. KI41/09, me parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14). Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 7/2019] të 2 prillit 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.
50. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e parashikuar në nenin 49 të Ligjit.
51. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (2) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, specifikon:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

52. Parashtruesi i kërkesës, siç është cekur më lart pretendon se Aktgjykimi [E. Rev. nr. 7/2009] i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse Gjykata Supreme (i) kishte interpretuar ligjin në mënyrë të gabuar, dhe (ii) nuk kishte arsyetuar aktgjykimin e saj. Parashtruesi po ashtu pretendon se në rastin e tij (iii) procedurat në tërësi nuk janë pajtim me të drejtën për zgjidhje efektive të rastit brenda një afati të arsyeshëm, dhe (iv) se në rastin e tij ka pasur edhe vendimmarrje në kundërshtim me një vendim “*res judicata*”.
53. Gjykata në vijim, do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(i) Pretendimet në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit

54. Për sa i përket (i) interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në nivelin e ligjshmërisë me qëllim të ndërtimit të shkeljeve të pretenduara, janë pretendime që ai i lidh me faktin se Gjykata Supreme me Aktgjykimin [E. Rev. nr. 7/2009] vetëm shkarazi ka trajtuar argumentet e paraqitura në revizion sepse dispozitat e ligjore të përmendura nga parashtruesi i kërkesës janë mbështetur në ligjin e vjetër për marrëdhëniet e detyrimeve të publikuar në gazetën zyrtare të RSFJ-së, kurse Gjykata Supreme ka interpretuar e zbatuar dispozitat e ligjit të ri për marrëdhëniet e detyrimeve (Ligji Nr. 04/L-077). Sipas parashtruesit nese do te aplikohet neni 154 dhe 155 te ligjit te vjetër për marrëdhëniet e detyrimeve të publikuar në gazetën zyrtare të RSFJ-së(1978), i cili ka qene ne fuqi ne kohen kur është krijuar marrëdhënia detyrimore kontestuese ne mes te palëve e qe

sipas parashtruesit “bën pjese tek Kaptina 2 e Kreut II te Ligjit të ri për marrëdhëniet e detyrimeve (Ligji Nr. 04/L-077) “*mund te arrihet përfundimi se detyrimi mund te lindë nga një raport kontraktual mes paleve (Kontrata), por edhe mund te lind nga një raport jo-kontraktual ne mes palëve (Demi, Fitimi pa baze, Gjerimi i punëve te huaja pa porosi dhe shprehja e njëanshme e vullnetit)*”.

55. Në mbështetje të shkeljeve të lartpërmendura, parashtruesi i kërkesës shton se “*Megënëse raporti detyrimor i krijuar me shkaktimin e demit te pales se paditur eshte krijuar gjate viteve 2000-2005 natyrisht se pala paditëse ju ka referuar dispozitave te LMD se se vjetër qe ka qene ne fuqi ne atë kohe.*”
56. Në lidhje me keto pretendime, Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 qershorit 2018, paragrafi 57).
57. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KI06/17, *Parashtrues L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 38; dhe KI122/16, *Parashtrues Riza Dembogaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 qershorit 2018, paragrafi 58).
58. Duke iu kthyer rastit konkret dhe kategorisë së parë të pretendimeve ankimore, Gjykata vëren se për parashtruesin e kërkesës ishte kontestues aplikimi i neneve respektive të Ligjit të ri të Marrëdhënieve të Detyrimeve ne vend të Ligjit të vjetër të marrëdhënieve të detyrimeve .
59. Nga shkresat e lendes gjykata verën se ne lidhje me pretendimin specifik te parashtruesit te kerkeses për zbatim të gabuar te drejtes materiale, se gjykata e ulëta kan vepruar në kundërshtim me nenin 17 dhe nenit 154 të LMD të vjetër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ne Aktgjykimin [E. Rev. nr. 7/2019], i 2 prillit 2019 kishte theksuar “*Pretendimin e cekur ne revision se gjykatat e instances me te ulet kane vepruar ne kundërshtim me nenin 17 dhe nenin 154 te LMD-se,*

kjo gjykate i vlerësoi si të pa bazuar, ngase në rastin konkret nuk permbushen kushtet ligjore për lidhjen e kontratës së detyrueshme parapare në nenin 17, ndërsa nën 154 I ligjit të cekur parashikon përgjegjësinë për dëmin I cili rrjedh nga sendi i rrezikshëm ose nga veprimtaria e rrezikshme e cila rrethane nuk perkon me rrethanat e rastit konkret.”.

60. Në lidhje me pretendimin specifik për zbatim të dispozitave të LMD të vjetër në vend të LMD të ri, (paragrafin 31 të këtij raporti) Gjykata vëren se pretendimi në fjalë nuk është ngritur në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën Supreme dhe se për herë të parë është ngritur në këtë Gjykatë. Gjykata thekson qëndrimin e saj parimor se, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta vlerësojë një pretendim apo një çështje e cila nuk është ngritur dhe vlerësuar paraprakisht nga gjykatat e rregullta (shih, Rasti Nr. KI89/15, *Parashtrues Fatmir Koci*, Aktvendim për Papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 22 marsit 2016, paragrafi 35). Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat pranë gjykatave të rregullta, në mënyrë që të parandalohet shkelja kushtetutëse apo të korrigjohen shkeljet e tilla pasi ato të kenë ndodhur. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë mundësitë në procedurat pranë gjykatave të rregullta (shih, Rasti Nr. KI24/16, *Parashtrues Avdi Haziri*, Aktvendim për Papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 nëntorit 2016, paragrafi 39 dhe referencat e përmendura aty).
61. Për sa i përket drejtësisë procedurale, Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqes argumente dhe dëshmi që ai i konsideroi relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtarë; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës Nr. KI118/17, *Parashtrues Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin Garcia Ruiz kundër Spanjës, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
62. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 7/2019, i 2 prillit 2019] si dhe në dy instancat tjera gjyqësore nuk është gjetur asgjë që do të çonte në konkludimin se gjykatat e rregullta kanë aplikuar dispozitat ligjore përkatëse në mënyrë të gabuar ose arbitrare, duke çuar në përfundimin se nuk ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në lidhje me pjesën e parë të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.

(ii) Pretendimet në lidhje me mungesën e vendimit të arsyetuar

63. Për sa i përket pretendimit (ii) se Gjykata Supreme nuk kishte arsyetuar aktgjykimin e saj, Gjykata vëren neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së obligojnë gjykatat që të japin arsye për vendimet e tyre, mirëpo ky obligim nuk mund të kuptohet si kërkesë për të dhënë përgjigje të detajuara ndaj çdo argumenti (shih, Van de Hurk kundër Holandës, paragrafi 61; García Ruiz, cituar më lart, paragrafi 26; Jahnke dhe Lenoble kundër Francës (Aktvendim); dhe Perez kundër Francës [DHM], paragrafi 81). Praktika gjyqësore e GJENDJ-së dhe ajo e Gjykatës theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet *“të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre”*. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.
64. Gjykata rikujton pretendimet specifike të parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor e të reflektuara në paragrafin 34 të këtij raporti.
65. Në këtë kontekst Gjykata vë në pah pjesën relevante të arsyetimit të Gjykatës Supreme, që përcakton: *“Gjykata Supreme ka vlerësuar [...] gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të bollshme për një aktgjykim të drejtë e të bazuar në ligj. Kjo ngase paditës me të paditurën Sharr Beteiligungs GmbH, me seli Hani i Elezit, nuk kanë qenë në raporte kontraktuale dhe detyrimet e Ndërmarrjes Shoqërore të Sharr Çimentores dhe kërkesat e paditësit të cilat kanë të bëjnë me periudhën para hyrjes në fuqi të kontratës mbi qiranë nuk mund t’i barten të paditurës, për deri sa të mos ketë pasur ndonjë marrëveshje apo akt juridik të ngjashëm me të cilin e paditura do të kishte pranuar detyrimet e Ndërmarrjes Shoqërore të Sharr Çimentores. Prandaj, me të drejtë gjykatat e instancës më të ulët kanë vlerësuar se të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë në procedurë [...] marrëveshja mbi qiranë, menaxhimin dhe operimin e Fabrikës së Çimentos “Sharr”, Hani i Elezit, në të cilën marrëveshje në kapitullin e katërt pika 4.2 është paraparë që UNMIK-u do të bëjë përpjekje të arsyeshme që të mbrojë punën e fabrikës nga kërkesat e çfarëdo kreditori, të cilat i përkasin periudhës para hyrjes në fuqi të kontratës mbi qiranë, nga e cila marrëveshje del konstatimi se e paditura nuk i detyrohet paditësit për borxhet e krijuara paraprake nga subjekti tjetër dhe nuk ka obligim të përmbush edhe detyrimet eventuale të mbetura të parealizuar”*.
66. Gjykata Supreme e Kosovës shton se *“paditësi ka dështuar të argumentoi faktin se e paditura ka qenë pjesëmarrëse në marrëdhëniet e detyrimeve me paditësin, që ta përmbush detyrimin e vet që rrjedhe nga marrëdhënia e detyrimeve, ashtu siç është paraparë në nenin 8 të LMD -ës, i cili parashikon se vetëm pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimeve kanë për obligim ta përmbushin detyrimin e vet, ndërsa në rastin konkret paditësi ka qenë në raporte kontraktuale me Ndërmarrjen Shoqërore sipas kontratave të cekura më lartë të viteve 1998 dhe 1999, kurse me të paditurën nuk ka qenë në asnjë raport detyrimor, andaj me të drejtë gjykatat e instancës më të ulët kanë vlerësuar se të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv në këto marrëdhënie, për*

te cilat arsye pretendimet e paditësit të cekura në revizion lidhur me zbatimin e gabuar të drejtës materiale nga kjo Gjykate u vlerësuan si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi thëniet e cekura në revizion lidhur me administrimin e provës Email-in e datës 31.5.2016 pasqyrën e kostos ditore të mjeteve të makinerisë; kërkesën për marrjen e lidhur me makinerinë e listuar; formularin e ATK-së dhe Pjesën II të revizionit, por të njëjtat nuk ndikuan që kjo Gjykatë të vendosë ndryshe nga ajo që kanë vendosur gjykatat e instancës më të ulët, sepse këto pretendime kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, për të cilat në bazë të nenit 214 të LPK-së revizioni nuk mund të paraqitet”.

67. Gjykata po ashtu vë në spikamë pjesët relevante të arsyetimit të Gjykatës së Apelit:

“Nga provat që gjenden në shkresat e lendes rrjedh se gjykata e shkalles së pare, me të drejte ka konstatuar se nuk ishte kontestuese se paditësi dhe Ndërmarrja Shoqërore "Sharr Çimentorja" me seli në Kaçanik kanë qene në raport kontraktues gjatë viteve 1998-1999, ku paditësi kishte marrë kryesisht detyrimet që të furnizojë NSH-ne me lenden e pare për prodhimin çimentos, të ashtu quajtur "Tuf" ndërsa Nsh-ja kishte marrë detyrime që paditësin ta kompensojë me çimento. Me datën 13.06.2000 AKM-ja si administratore ligjore e NSH-se ka lidhur marrëveshje mbi qiranë, për menaxhimin dhe operimin e fabrikës së çimentos "Sharri", me "Sharr Beteiligungs" GMBH, ku AKM-ja është paraqitur si qiradhënëse, ndërsa kjo e dyta si qiramarrëse. Me kontratë të komercializimit, "Sharr Beteiligungs" GMBH nuk kishte marrë detyrimet për pagesat e detyrimeve të mëparshme. Konkretisht me kapitullin katër të kontratës pika 4.2 ishte theksuar se UNMIK-u do të bëjë përpjekje të arsyeshme që të mbrojë punën e fabrikës nga kërkesat e çfarëdo kreditori, të cilat i përkasin periudhës para hyrjes në fuqi të kontratës mbi qiranë.

Prandaj, Gjykata e Apelit, ashtu si edhe gjykata e shkalles së pare, ka ardhur në përfundim se në këtë procedurë gjyqësore, të padituesit i mungon legjitimiteti pasiv për të qene palë respektivisht i mungon përgjegjësia për kompensimin e borxheve eventuale apo detyrimeve mbi kamatë vonesat dhe fitimi i humbur. Pavarësisht faktit nëse paditësit i janë përmbushur apo jo të gjitha detyrimet nga Ndërmarrja Shoqërore "Sharr Cementorja" si palë kontraktuese, detyrimet e saj nuk i barten "Sharr Beteiligungs" GMBH, për derisa të mos ketë pasur ndonjë marrëveshje apo akt juridik të ngjashëm me të cilin e paditura do të kishte pranuar detyrimet e NSH-se "Sharr Çimentorja". Në kapitullin 4 të marrëveshjes së qirase, pika 4.2 është përcaktuar qartazi se "Sharr Beteiligungs GMBH", si qiramarrëse, nuk ka asnjë detyrim mbi borxhet paraprake eventuale të NSH-se "Sharr Çimentorja". Fakti i pretenduar nga paditësi se e paditura si qiramarrëse ka trasheguar asetet dhe stoke nga NSH "Sharr Çimentorja" nuk paraqet ndonjë bazë ligjore mbi të cilën do të krijohet detyrimi i të padituesit për përmbushjen e detyrimeve eventuale të mbetura, e të pa realizuara nga NSH "Sharr Çimentorja".

68. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë trajtuar aspektet qendrore të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës dhe kanë shpjeguar dhe

interpretuar dispozitat përkatëse të marrëveshjes për qiranë, menaxhimin dhe operimin e fabrikës së çimentos “NSH Sharr Çimentorja” me ç’ rast kanë konstatuar mungesën e legjitimitetit pasiv të palës së paditur “Sharr Beteiligungs” lidhur me borxhet parapake. Gjykata në këtë kontekst thekson se gjykatat janë të detyruara të arsyetojnë pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës por se ky detyrim nuk nënkupton që gjykatat duhet të përgjigjen në secilin argument të parashtruar nga parashtruesit në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës në lidhje me aktgjykimin Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 7/2009] të 2 prillit 2019 por edhe përgjatë vendimeve të gjykatave të tjera të rregullta, në tërësinë e tyre ishin mjaftueshëm të arsyetuara dhe nuk janë karakterizuar nga “arbitrariteti i dukshëm” siç pretendon parashtruesi i kërkesës.

69. Parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të GJEDNJ-së Helle kundër Finlandës dhe Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI72/12. Megjithatë, në rastin nr. KI72/12 Gjykata kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së për shkak se gjykatat e rregullta nuk kishin dhënë përgjigje ndaj çështjeve specifike dhe qendrore që kishte ngritur parashtruesi i kërkesës, kurse në rastin konkret gjykatat e rregullta kanë adresuar të gjitha pretendimet qendrore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës gjatë zhvillimit të procedurës së rregullt.
70. Në rastin Helle kundër Finlandës, GJEDNJ-ja kishte theksuar se kriter i procesit të rregullt gjyqësor, në ankesat tek gjykatat e apelit, përcakton si kriter jo vetëm, thjesht, miratimin e konstatimeve të gjykatave të instancës më të ulët por edhe adresimin e të gjitha pretendimeve qendrore në kuadër të juridiksionit të apelit. Në rastin në fjalë, GJEDNJ-ja, kishte konstatuar, se në rrethanat e rastit konkret, procedurat nuk kishin qenë të padrejta karshi pretendimeve që kishte ngritur ankuesi. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Helle kundër Finlandës*, Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafët 60-61). Ngjashmërisht, edhe në rastin konkret, Gjykata Supreme ka vërtetuar-konstatimet e gjykatave të instancave më të ulët-dhe ka dhënë përgjigje ndaj të gjitha çështjeve qendrore duke shpjeguar: (i) faktin se parashtruesi nuk ka pasur raport kontraktual me palën e paditur përkatësisht kësaj të fundit i ka munguar legjitimiteti pasiv; (ii) parashtruesi ka dështuar të argumentojë se pala e paditur ka qenë pjesëmarrëse në marrëdhëniet e detyrimeve për t’i përmbushur ato në pajtim me nenin 8 të LMD-së; dhe se, (iii) në kapitullin 4 të marrëveshjes për qiranë, pika 4.2 ishte përcaktuar qartazi se pala e paditur, si qiramarrëse, nuk ka asnjë detyrim për borxhet parapake eventuale të NSH “Sharr Çimentorja”.
71. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e kontestuar është përgjigjur në mënyrë konkrete ndaj pretendimeve qendrore të parashtruesit por edhe lidhur me administrimin e drejtë të rastit nga gjykatat e instancës më të ulët. Gjykata po ashtu konsideron se nuk rezulton se procedurat e zhvilluara në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm kanë qenë të përfshira nga “arbitrariteti i dukshëm” që do ta bënte vendimmarrjen e tyre të papajftueshme me standardet e një vendimi të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KI55/19, *Parashtrues Ramadan Osmani*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 23 janarit 2020, paragrafi 46).

(iii) Pretendimet ne lidhje me zgjidhjen efektive brenda një afati të arsyeshëm

72. Për sa i përket pretendimit (iii) për zgjidhje efektive brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata i referohet kriterëve të nxjerra nga jurisprudenca e konsoliduar e GJEDNJ-së që përcaktojnë : (a) ndërlikueshmëria e rastit; (b) sjellja e palëve në procedurë; (c) sjelljen e gjykatave kompetente apo autoriteteve tjera publike në procedurë; dhe, (ç) çfarë rrezikon të humb parashtuesi në kontest (shih GJEDNJ, Rasti *Mikulic kundër Kroacisë*, ankesë nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 38).
73. Si çështje paraprake lidhur me pretendimin për zgjidhje efektive në afat të arsyeshëm, Gjykata vëren se kontrata e parë ndërmjet Parashtruesit të kërkesës dhe fabrikës së çimentos “NSH Sharr Çimentorja” është lidhur në vitet 1998-99 kurse fabrika e çimentos “NSH Sharr Çimentorja” ka kaluar në administrimin e AKM-së në vitin 2000, çka më vonë ka rezultuar me procedura gjyqësore që kishin filluar në vitin 2005.
74. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në pajtim me juridiksion kohor të saj, kohëzgjatja e procedurave llogaritet nga 15 qershori 2008 deri në vitin 2019. Gjykata po ashtu vëren: (i) se gjykatat nuk kanë qëndruar pasive sepse procedura është zhvilluar në tri instanca gjyqësore; (ii) në dy raste tjera procedura është zhvilluar edhe në DHPGJS anë pse kjo e fundit ka shpallur vetveten jo-kompetente dhe çështjen e ka kaluar tek gjykatat e rregullta; dhe se (iii) procedura ka qenë e ndërlikuar sepse është dashur të qartësohen aspekte të kalimit të mjeteve, pronës, borxheve paraprake dhe punës nga një entitet në tjetrin ku kanë qenë të përfshira disa palë (parashtruesi i kërkesës, fabrika e çimentos “NSH Sharr Çimentorja”, “Sharr Beteiligungs” dhe AKM-ja), ku secila ka mëtuar t’i mbrojë interesat personale.
75. Sa më sipër, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procedurave në tërësi duke pasur parasysh juridiksionin kohor të saj, procedurat zhvilluara në DHPGJS dhe gjykatat e rregullta, ndërlikueshmërinë e rastit, sjelljen e palëve dhe çfarë ka rrezikuar parashtuesi, nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese, Rasti nr. KI23/16 Parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 12 majit 2017, paragrafi 75 dhe referencat e përmendura aty).

(iv) Pretendimi në lidhje me shkeljen e parimit “res judicata”

76. Në lidhje me pretendimin e parashtuesit të kërkesës (iv) se në rastin e tij ka pasur edhe vendimmarrje në kundërshtim me një vendim “*res judicata*”, Gjykata vëren se parashtuesi vetëm sa e ka përmendur pretendimin për cenim të parimit të çështjes së gjykuar *res judicata*, mirëpo, nuk ka shpjeguar saktësisht dhe nuk mbështetur me prova se si parimi i pretenduar është cenuar në dëm të tij (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese rasti nr. KI142/15 Parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafët 48-49).

77. Gjkata në fund thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm apo edhe për shkeljen e të drejtave në mbrojtje gjyqësore të tyre. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe po ashtu shih Gjkata Kushtetuese, Rasti nr. KI56/17, *Parashtrues Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
78. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113. 7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 1 korrik 2020, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi